

Z. Genci Kokaj është diplomuar në vitin 1993 në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave si “Inxhinier i nxjerrjes së naftës dhe gazit”.

Nga viti 1994 ka punuar si Inxhinier në Ndërmarrjen e Nxjerrjes së Naftës, ndërsa në periudhën 2005-2009 ka mbajtur detyrën e Drejtorit në ARMO Sh.a, Filiali i Import-Ekportit e Tregtimit të Karburanteve, Vlorë.

Z. Kokaj ka filluar punë në KLSH në vitin 2012, ku ka mbajtur pozicione të ndryshme si Auditues i Parë dhe Auditues i Lartë si dhe ka qenë i angazhuar në disa nga Departamentet e Auditimit, si në Departamentin e Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja, Departamentin e Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore, duke krijuar eksperiencë në sektorë të ndryshëm të administratës publike. Aktualisht, ushtron detyrën e Kryeaudituesit në Departamentin e Auditimit të Mbrojtjes, Sigurisë dhe Pronës Publike.

Gjatë karrierës së tij profesionale në KLSH, ka marrë pjesë në trajnime, konferenca, seminare dhe workshope të organizuara si brenda vendit ashtu edhe jashtë nga institucionet homologe ndërkombëtare konkretisht në Turqi, Poloni, etj., për çështje të auditimit të jashtëm publik, auditimit financiar dhe të përputhshmërisë, prokurimeve publike, mashtrimit dhe korrupsionin, etj.